



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.09.2018, ora 10:00

#### Drejton mbledhjen:

**Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit  
dhe kryetar i grupit “Miqtë e fëmijëve”**

#### Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 20 korrik 2018.
2. Diskutimi i propozimeve për disa ndryshime në ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.

  - Prezantimi i propozimeve nga ekspertët
  - Diskutime nga pjesëmarrësit

3. Çështjet të tjera.

#### Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Blerina Gjylameti, Eglantina Gjermani, Nora Malaj, Klodiana Spahiu, Musa Ulqini, Edlira Bode, Milva Ekonomi, Adelina Rista, Ulsi Manja, Elisa Spiropali, Ervin Bushati, Ermonela Felaj dhe Elona Gjebrea.

#### Të ftuar:

Jawad Aslam - zëvendësperfaqësues i UNICEF-it në Shqipëri

David Gvineria - specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve

Emira Shurti - specialiste te “Drejtësia për të miturit”

Iva Zajmi - eksperte e grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”

Pablo Zapata – Kryetar i Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë

Eduart Moreno – oficer i mbrojtjes në UNHCR

Artur Marku – specialist në UNHCR  
Delina Cici – përfaqësuese e Këshillit të Europës  
Rajmonda Bozo - drejtuese e TLAS-ës  
Rudina Brari - eksperte e TLAS-ës  
Viktor Gumi -ekspert i TLAS-ës  
Vangjel Kosta - ekspert i TLAS-ës  
Artemis Dralo – zëvendësministre për Europën dhe Punët e Jashtme  
Romina Kuko – zëvendësministre e Punëve të Brendshme  
Rovena Voda - zëvendësministre e Punëve të Brendshme  
Lindita Nikolla - ministre e Arsimit, Rinisë dhe Sportit  
Mira Rakacolli – zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Toni Gogu - zëvendësministër i Drejtësisë  
Pandeli Majko - Ministër i Shtetit për Diasporën  
Nejla Peka - Komisionere e Seksionit të Fëmijëve  
Anila Nepravishta - ndihmëskomisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi  
Robert Gajda - Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi  
Alda Hoxha - përfaqësuese e Agjencisë për Mbrojtjen e Drejtave të Fëmijëve  
Bledar Doracaj - drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile  
Blerina Celoaliaj – përfaqësuese e “Save the Children Albania”  
Anila Meco - përfaqësuese e “Save the Children Albania”  
Julinda Vokopola – përfaqësuese e ARSIS  
Altin Hazizaj – përfaqësuese e Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, CRCA  
Miriam Angoni - përfaqësues i Komitetit të Helsinkit  
Kejsi Ziu – përfaqësuese e Qendrës Nisma Ligjore për qytetarët  
Rezana Shehu – përfaqësuese e Observatorit për të Drejtat e Njeriut  
Denisa Daka – përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Avokatisë  
Ariana Fullani - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Avokatisë  
Evelina Qirjako - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Avokatisë

## HAPET MBLEDHJA

**Gramoz Ruçi** – Përshëndetje të gjithëve!

Nuk kam ndër mend të mbaj ndonjë fjalë hapjeje, sepse kjo mbledhje është vazhdim i mbledhjes së radhës së grupit “Miqtë e fëmijëve”. Në përfundim të asaj mbledhjeje, në mos gaboj, arritëm në përfundimin se në fund të muajit shtator do të rimblidheshim për të konkretizuar zgjidhjen e shqetësimit të shtruar si nga partnerët tanë të organizatave ndërkombëtare, ashtu edhe nga ekspertëve për një problem shumë të madh, siç është çështja e mosregjistrimit të një numri të konsiderueshëm fëmijësh. Arritëm në përfundimin se kjo kërkonte një zgjidhje ligjore.

Gjatë kësaj periudhe është punuar, në zbatim të atyre konkluzioneve që ishin arritur nga studimet e bëra, ekspertët kanë punuar dhe kanë arritur në një projekt-draft për zgjidhjen ligjore të kësaj çështjeje.

Pa u vonuar ftoj, njëherësh duke i falënderuar për punën e bërë ekspertët, që të parashtrorjnë projektin. Më pas të gjithë të ftuarit dhe grupi i deputetëve janë të ftuar të japin mendime për këtë projekt, me qëllim që në kalendarin që ka Kuvendi për këtë muaj nga projekt, të institucionalizohet, sipas rregullave që ka Kuvendi, për t’u diskutuar në Komisionin e Ligjeve dhe më pas për t’u miratuar në seancën plenare.

Fjala për zotin Gumi.

**Viktor Gumi** - Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar pjesëmarrës,

Sikurse u vendos edhe si detyrim për grupin e ekspertëve herën e kaluar për të përgatitur amendamentet ligjor, ne kemi ardhur të paraqesim një grup amendamentesh të ligjit “Për gjendjen civile”. Këto janë një grup amendamentesh, të cilat reflektojnë shqetësimet dhe problematikat e ngritura edhe në tryezën e parë dhe është një produkt, i cili paraprakisht i është nënshtruar konsultimit si me aktorët e ekzekutivit, ashtu edhe me shoqatat e tjera. Kjo nuk do të thotë se ky është produkt final, është ende në diskutim dhe mirëpresim çfarëdo gjëje, komenti, pyetje apo observacione që do të lindë nga kjo tryezë, por, njëkohësisht, edhe nga shqyrtimi që do t’i bëhet më vonë, kur të marrë trajtën dhe formën e iniciativës së ligjvënës.

Teksti i projektligjit që kemi punuar ka të bëjë totalisht me atë pjesë, e cila u ngrit si problematikë herën e kaluar, që reflekton me zgjidhje ligjore shqetësimet e ngritura.

Është një grup dispozitash që prek ligjin “Për gjendjen civile” dhe në hartimin e tekstit të këtyre dispozitave jemi përpjekur që të gjejmë një balancë të duhur midis rixhitetit që duhet të ketë një akt ligjor dhe fleksibilitetit që duhet t’u krijohet organeve kushtetuese të ekzekutivit për të trajtuar çështje dhe për të zgjidhur problematika me një natyrë teknike të theksuar.

Konkretisht, ajo që propozojmë për ndryshim në ligjin “Për gjendjen civile” duke pasur parasysh edhe çështjen e aktit normativ, është shtimi i nenit 38/1, që zgjidh një problematikë, e cila u konsiderua edhe në shifra, por edhe si serioze dhe në vijimësi në mbledhjen e kaluar, për aktet e lindura, të mbajtura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por që kishin të dhëna të paplota dhe të pasakta. Edhe mes nesh kemi pasur një debat nëse një dispozitë e tillë e ka vendin në ligjin “Për gjendjen civile”, apo e ka vendin, si një normë procedurale, në Kodin e Procedurës Civile? Ne gjykuam, vlerësuam dhe konkluduam që ligjvënësi mundet dhe është ligjore që një dispozitë, me një formulim të tillë, ta parashikojë në ligjin “Për gjendjen civile”.

Së pari, është një praktikë që norma procedurale ligjvënësi për gjykatat nuk është se i ka parashikuar vetëm në Kodin e Procedurës Civile, por i ka parashikuar edhe në ligje që kanë një shumicë të thjeshtë. Rasti më etalon që e përdorim rëndom në këtë pikë, është rasti i ligjit “Për disa masa ndaj dhunës në familje”.

Së dyti, ndërhyrja dhe teksti që ne kemi parashikuar në këtë nen nuk bën asnjë devijim nga normat procedurale klasike të gjykatës. Përkundrazi merret një institut i detajuar në Kodin e Procedurës Civile dhe ajo që bëjmë është të vendosim disa afate dhe një procedurë, e cila ndjekë këtë pjesë të Kodit të Procedurës Civile. Pra, i jepet juridiksioni gjykatës shqiptare të shqyrtojë këtë çështje dhe jo t’i kthejë njerëzit duke u thënë: “Shkoni në vendin ku keni aktin e lindjes për të rregulluar këtë të metë”, ku veçanërisht shtresat në nevojë e kishin të pamundur të shkonin në vendin e lindjes. Gjykata futet në këtë proces me vërtetim fakti juridik për të respektuar parimin e kontradiktetit dhe për të bërë të mundur edhe ekzekutimin e vendimit në fazën përfundimtare, thërret si person të tretë zyrën e gjendjes civile dhe vendosen dy afate konkrete, 45 ditë, dhe pastaj për ankimin brenda Dhomës së Këshillimit në Gjykatën e Apelit.

Diskutimi i dytë që kemi bërë dhe propozojmë amendamente është neni 40, pika 2, përveç fjalëve “organet e njësisë së qeverisjes vendore” të shtohen fjalët “njësitë për mbrojtjen e fëmijës”. Kjo ka të bëjë me rastin e deklarimit të fëmijëve të gjetur, kur ka një sërë institucionesh shtetërore, të cilët duhet të marrin veprime konkrete. Në reflektim edhe të ligjit për të drejtat e fëmijëve dhe të çdo kuadri ligjor, që është mbajtur në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, ne gjykojmë që këtu duhet të marrin rol të posaçëm, përderisa janë nominativë të posaçme, njësitë e mbrojtjes së fëmijës.

Neni 40, pika 3, reflekton atë parim, i cili gjendet në frymën e ligjit, por nuk gjendet i shprehur në nenin konkret. Pra, së pari, detyrimi për regjistrimin e fëmijëve dhe plotësimi i formaliteteve qëndron te prindi që ka lindur këtë fëmijë, por, natyrisht, shteti nuk mund të qëndrojë indiferent në qoftë se një gjë e tillë nuk zbatohet nga prindi dhe ky nen thekson pikërisht këtë gjë, që me kalimin e afateve kohore duhet të futen institucionet shtetërore për të bërë të mundur regjistrimin e fëmijëve. Kjo ndodh sepse, sikur e theksuam edhe në prezantimin e parë, regjistrimi është e drejta për të pasur të drejta dhe shteti në këtë *domain* ka një rol aktiv, që duhet të luajë aty.

Neni 41, ka qenë me një përmbajtje disi më ndryshe, është shfuqizuar në vitin 2016 dhe ne gjykojmë që është me vlerë të futet përsëri përmbajtja e nenit 41, pika 3, por me një formulim më ndryshe. Pra, për të gjithë ata persona që lindin fëmijë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është mirë që të vënë në funksionim gjendjen civile të atyre vendeve dhe pastaj, nëse nuk bëhet një gjë e tillë, është e pamundur për një sërë arsyesh, atëherë mund të vendosin shërbimet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 41, pika 6, ne kemi bërë një arsyetim teknik, që kërkojmë shfuqizimin e kësaj pike, sepse titulli ka fjalën “regjistrim i aktit të lindjes”, ndërkohë që pika 6 nuk bën gjë tjetër vetëm citon “deklarim” dhe për këtë ne kemi thënë që duhet të shfuqizohet nga kjo pjesë dhe e gjithë procedura e deklarimit duhet të ketë një nen tjetër, pas nenit 41 të shtohet një pikë tjetër me këtë përmbajtje, ku të gjitha institucionet shtetërore dhe private të jenë të detyruar që brenda një afati kohor të përcaktuar të deklarojnë lindjet së bashku me dokumentacionin përkatës. Për çdo lindje të raportuar, zyra e gjendjes civile duhet të krijojë një regjistër të përkohshëm dhe të mbajë këtë regjistrim. Është ministri që do të nxjerrë aktet nënligjore për administrimin e regjistrimit të përkohshëm. Ndërkohë, brenda një afati 60-ditor, i cili ka qenë në ligj dhe e ne e kemi mbajtur, megjithëse është një çështje që mund ta diskutojmë, mund të mos ketë reflektim në regjistrin kombëtar, pra të regjistrohen në mënyrë përfundimtare këto lindje. Atëherë, vetë sistemi duhet të ketë një mënyrë të tillë, që të vendosë disa dispozita dhe disa sinjalizime, ku me tejkalimin e këtij afati dhe fëmijët të mos ngelin të paregjistruar është e domosdoshme që institucionet shtetërore të ndërmarrin veprime përkatëse për të bërë të mundur regjistrimin e këtyre fëmijëve.

Ligji përfundon me disa dispozita, të cilat kanë të bëjnë me një natyrë teknike dhe konkrete, siç është dispozita e sanksioneve në nenin 45, pika 3. Nisur edhe me një praktikë që ka ndodhur me TLAS-in (Shërbimi Ligjor Falas në Tiranë), ku ka një numër të madh fëmijësh, veçanërisht për fëmijët e lindur në Greqi, ku rubrika e emrit gjendet bosh, gjykojmë që për

arsye ekonomike të vendosim emrin e një fëmije dhe të vëmë në lëvizje institucionin gjykatës nuk shkon.

Së dyti, emri si përbërës është i prejdardhur dhe nuk krijon lidhje jetike, sepse, në fund të ditës, është një emër, i cili vendoset me pëlqimin e të dy prindërve dhe gjatë jetës së fëmijës edhe mund të ndryshojë. Prandaj, veçanërisht për këtë rubrikë, momentalisht TLAS-i është në shqyrtim të 80 kërkesave, ku ka një stok prej 80 kërkesash, ku rubrika e emrit është bosh. Vlerësojmë dhe gjykojmë se ndoshta se kjo është një procedurë administrative, rregullat e detajuara të secilës do të përcaktohen me akte nënligjore, ku, brenda kësaj procedure, me pëlqimin e prindërve, të vendoset emri dhe të bëhet regjistrimi përkatës. Këto janë përgjithësisht pikat që ne kemi menduar se janë të nevojshme dhe të domosdoshme për ndryshime në ligj për të reflektuar atë problematikë që u shqyrtua herën e parë. Ndryshmi i ligjit përbën pikën e nisjes, por jo pikën përfundimtare, sepse kjo duhet të pasohet njëkohësisht edhe me shumë akte nënligjore. Në këtë pikë parashikojmë dy ose tri akte nënligjore, të cilat duhet të jenë udhëzime të ministrave.

Për sa u përket sfidave të zbatimit të këtij ligji, duke u nisur edhe nga efektiviteti, produktiviteti i këtij grupi, edhe në këtë çështje që u përqa, ne duam në përfundim të sjellim në vëmendjen tuaj atë që mes nesh e quajmë komponenti i heshtur i reformës në drejtësi (diskutimet që janë KLGJ-ja, KLP-ja), pra ngritja e organeve, të cilat natyrisht që kanë rëndësinë e tyre dhe janë themelore e vendimtare.

Në vëmendje të grupit, por besojmë edhe të parlamentit, është me rëndësi të kihet edhe zbatimi i ligjit për ndihmën juridike. E gjithë kjo procedurë që kemi parashikuar, veçanërisht për shtresat në nevojë, do të bëhet e mundur, efektive dhe praktike, jo iluzive dhe teorike në qoftë se mungon ndihmë juridike. Aktualisht, një gjë e tillë është. Vetë ekzekutivi e ka pranuar që ndihma juridike është një sistem në kolaps. Është miratuar ligji i ri për ndihmën juridike në mes të dhjetorit të vitit 2017. Ligji parashikonte hyrjen në fuqi më 1 qershor të vitit 2018. Neni përkatës parashikonte që aktet nënligjore të nxirreshin brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit për ndihmën juridike. Ne nuk dimë të ketë, të paktën në Fletoren Zyrtare, ndonjë akt nënligjor të zbatuar për ndihmën juridike, ashtu sikundër besojmë dhe vlerësojmë se, duke e futur si pjesë të axhendës së këtij grupi në muajt në vijim, jemi në kohë për të parë edhe planifikimet financiare buxhetore, me qëllim që skema të jetë efektive që në janar të vitit 2019. Pra, ligjvënësi t'i parashikojë në këtë moment detyrimet buxhetore dhe alokimin e fondit të mjaftueshëm, sepse është e kuptueshme, duhen dhënë 5 lekë në vitin 2018 që në vitin 2019 të vëmë 10 lekë, në vitin 2020 20 lekë dhe kështu me radhë. Pra, po flas thjesht nga ana figurative për sistemin progresiv që duhet të ketë buxheti i shtetit për këtë skeme.

Është e kuptueshme që organizatat jofitimprurëse do të kenë pjesën e tyre të sensibilizimit për këtë gjë. Në këndvështrimin e TLAS-it është mjeti më i duhur dhe më i shpejti për të zgjidhur hallet e njerëzve që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike në këtë drejtim. Gjithashtu, kërkojmë që edhe shteti të marrë masa në këtë drejtim. Gjykojmë dhe vlerësojmë se dy sfida do të jenë të vlefshme për bazën e re legislative dhe, për sa kohë kemi ndryshim të qëndrimit të gjykatës në këtë drejtim, do të jetë i nevojshëm trajnimi i gjyqtarëve në lidhje me amendimet e reja të këtij ligji, ashtu sikurse edhe nëpunësit e gjendjes civile duhet të trajnohen, të sensibilizohen, me qëllim që të zbatohen në praktikë, në germë dhe në frymë dispozita e ligjit. Këto ishin shkurtimisht ato që kemi parashikuar dhe që propozojmë për diskutime dhe komente në këtë tryezë. Duke ju falënderuar, jemi të hapur për çfarëdolloj komenti apo pyetje që mund të keni.

**Gramoz Ruçi** – Shumë faleminderit, zoti Gumi!

A ka pyetje lidhur me prezantimin? Besoj se amendimet janë shpërndarë.

**Robert Gajda** – Unë kam vetëm diçka lidhur me propozimet. Nuk po u hyj në thelb, sepse kuptohet që ju, duke qenë në bashkëpunim me TLAS-in dhe duke u nisur nga rastet konkrete, keni pasur një arsye më të mirë për t'i përpiluar në thelb këto dispozita. E vetmja gjë që më shqetëson është se për zbatimin e këtyre dispozitave parashikohet nxjerrja e shumë akteve nënligjore, ta paktën 5 të tilla, sa numërova unë shpejt e shpejt. Ju përmendët edhe ligjin për ndihmën juridike, ku janë parashikuar akte nënligjore, të cilat nuk kanë dalë ende. Nuk do të ishte mirë të vendosim afate për nxjerrjen e këtyre akteve. Në një farë mënyrë, të mos e lëmë në dorë të lirë të pushtetit ekzekutiv, por të mundohemi t'i vendosim edhe afate, që t'i presojmë, për nxjerrjen sa më shpejt të akteve, duke pasur parasysh edhe numrin e lartë të fëmijëve që kemi, problematikat që janë gjeneruar në kohë e të tjera, për t'i dhënë një lloj zhdërvjelltësie e rrjedhshmërie zbatimit të ligjit? A do të ndihmonte kjo?

**Viktor Gumi** – Faleminderit!

Në parim jemi dakord. Besojmë se është e vlefshme dhe e nevojshme të shtohet një dispozitë këtu, duke parashikuar një afat konkret për nxjerrjen e akteve nënligjore nga ministrinë, siç është trajtimi klasik që kemi bërë tek ligji “Për ndihmën juridike”.

Megjithatë, përderisa kjo është një çështje që u ngrit për raportin e aktit ligjor me aktin nënligjor, mbase është momenti të kthehemi e të shikojmë një ide, e cila ka qenë në strukturat e parlamentit, pikërisht në lidhje me këtë teorinë e raportit të aktit ligjor dhe aktit nënligjor. Në fillim fare është diskutuar; nuk e di, mbase është koha ta rishikojmë sërish, që tekstet e projektligjeve në parlament të vijnë si iniciativa ligjore, por njëkohësisht të jenë të shoqëruara edhe me aktet nënligjore, kjo do të thotë dy elemente, që besoj se kishin problematikë dhe

zgjidhnin një çështje të caktuar. Së pari, ishte një punë paraprake, që nuk shtyhej në kohë, por vinte si paketë. Jo se do të miratohej në parlament, por do të reflektonte diskutime në parlament. Së dyti, edhe ligjvënësi kishte mundësinë të shikonte nëse elementë të caktuar të përmbajtjes e kishin vendin në aktin nënligjor apo kishin nevojë të vendoseshin në tekstin e ligjit.

Në lidhje me vërejtjen konkrete, mund të vendosim një dispozitë, që të përcaktojmë një afat konkret kohor për ministrat në dispozicion. Ashtu si edhe në diskutime, ne kemi menduar të përfshihemi edhe në hartimin e akteve nënligjore, duke shpresuar se do të japim kontributin tonë me aq sa mundemi.

**Gramoz Ruçi** – Pyetje tjetër?

**Evelina Qirjako** – Kam një pyetje, e ndoshta edhe një koment, në lidhje me një dispozitë të materialit që keni referuar.

E nisim me mënyrën se si është formuluar shtesa që bëhet në nenin 38/1: “Në rastet kur akti i lindjes, i mbajtur në një shtet tjetër, ka të dhëna të paplota ose të pasakta, gjykata bën vërtetimin e faktit juridik”.

Kam frikë se, në qoftë se do t’i referohemi ligjit, Kodit të Procedurës Civile në lidhje me vërtetimin e faktit juridik, kjo bie pak ndesh, pasi, në qoftë se do të shikojmë konceptin që ka pasur ligjvënësi te vërtetimi i faktit juridik, i cili është një gjykim shumë i veçantë, bëhet fjalë vetëm në ato raste kur dokumenti është zhdukur, është asgjësuar dhe është i pamundur të bëhet. Pra, janë disa raste ekstreme, një situatë e tillë ligjore, për të cilat ligjvënësi ka parashikuar për të bërë vërtetimin e faktit juridik.

Në proceset administrative, të gjitha rastet kur dokumentet janë të pasakta apo të paplota korrigjohen ose nga organi administrativ ose nëpërmjet një gjykimi të posaçëm ku korrigjohen këto akte. Mos ndoshta fakti që ky lloj procesi do t’i nënshtrohet vërtetimit faktit juridik, do të krijojë problem në praktikë në lidhje me konceptin e gjykimit të vërtetimit të faktit juridik? Pastaj, duke thirrur si person të tretë zyrën e Gjendjes Civile, që do të jetë subjekti që do të detyrohet, mos futemi në një gjykim gjysmë civil, gjysmë administrativ, që përsëri do ta vështirësojë praktikën gjyqësore?

Kjo ishte një lloj pyetjeje, që unë e kisha merak.

**Vangjel Kosta** – Ka qenë shqetësim vërtet shumë i veçantë i grupit, gjatë draftimit të kësaj dispozite.

Viktori e tha në parashkrimin e tij, që rruga tradicionale e rregullimit të këtyre problematikave do të ishte: personi që ka një dokument të tillë t’i drejtohet organeve që kanë lëshuar dokumentin në shtetet e huaja. Ajo me të cilën ne po përballemi sot, në përvojën e shtetasve shqiptarë, sidomos të atyre që kanë qenë në emigracion të paligjshëm, është



pamundësia për t'u rikthyer në vendin ku është lëshuar dokumenti i lindjes së fëmijëve. Këta persona janë para alternativave të pamundësisë për të rregulluar ligjërisht këtë dokument në vendin ku është mbajtur.

Shteti shqiptar ose duhet të kthejë kurrizin e të thotë: zgjidheni vetë atë gabim që keni bërë, ose duhet të japë alternativa, për t'u krijuar mundësi këtyre shtetasve që të realizojnë atë që u tha edhe pak më parë, të drejtën e fëmijës për të qenë i regjistruar. Do të mbajmë në konsideratë që pasoja është pikërisht fakti që fëmijët mbeten të paregjistruar.

Lidhur me shqetësimin teknik, Kodi i Procedurës Civile e parashikon vërtetimin e faktit, në kontekstin e mungesës së dokumentit apo mundësisë për ta marrë dhe ne besojmë që vetë ky kod në paragrafin e fundit ka parashikuar edhe mundësinë e korrigjimit të dokumenteve, si më sipër, thuhet në paragrafin e fundit të kësaj dispozite. Për sa kohë vetë Kodi i Procedurës Civile pranon korrigjim dokumenti, domethënë që dokumenti ekziston, por duhet korrigjuar, ne themi jemi në të njëjtën filozofi të kësaj dispozite dhe nuk po bëjmë një ndryshim thelbësor të dispozitës.

Për sa i përket thirrjes së zyrës së Gjendjes Civile, edhe ligji i sotëm parashikon thirrjen e personave të interesuar, thotë Kodi i Procedurës Civile, për të marrë pjesë në gjykime të tilla, në mënyrë që ato të jenë aktivë për ta investiguar sa më saktësisht gjykata faktin në mënyrë që të mos kemi abuzime me krijim identitetesh të pavërteta të fëmijëve.

Kështu që shqetësimi është i mirëkuptuar, por në thelb unë besoj se nuk kemi bërë ndryshim të pakapërcyeshëm të atij instituti që tanimë ne e kemi në Kodin e Procedurës Civile.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Urdhëroni!

**Altin Azizaj** – Përshëndetje!

Unë jam Altin Azizaj nga CRCA – Shqipëri. Unë desha ta nisja me një përgëzim për sa i përket klasit, sepse eksperiencia e përditshme në të dyja zyrat na ka treguar se sa probleme të vërteta kemi në regjistrimin e fëmijëve dhe unë shpresoj se këto ndryshime, por edhe ndryshime të tjera janë pa diskutim të nevojshme dhe që duhen mbështetur.

Në fakt, unë doja të ngrija një shqetësim që s'ka të bëjë me klasin, por ka të bëjë me mënyrën se si organizohet një proces ligjor në Shqipëri. Në sirtarët e Kuvendit fle një nismë ligjore që kërkon të mbrojë fëmijët nga dhuna seksuale. Ndryshimet në Kodin Penal i keni marrë zyrtarisht që të gjithë, Komisioni i Ligjeve dhe shumë komisione të tjera dhe mua më vjen keq të them se sot e kësaj ditë nuk ka një përgjigje zyrtare, sepse fëmijët në Shqipëri ende nuk mbrohen nga dhuna seksuale që ndodh online.

Ajo që ne duam të nxisim është që nisma të tilla të parlamentit, aq më shumë në emër të grupit parlamentar “Miq të Fëmijëve”, janë nisma të koordinuara të cilat nuk merren vetëm me një aspekt të të drejtave të fëmijëve, por merren me të gjithë të drejtat e fëmijëve.

Sot, siç e tregojnë edhe një sërë raportesh, çështja e dhunës seksuale online është çështja më e rëndësishme dhe e gjithë bota po i kushton vëmendje, sepse shumica e të gjitha veprave penale nuk po ndodhin në jetën reale, aty ku ka një veprim juridik, kuptohet, por i gjithë angazhimi po përqendrohet në botën online. Në këtë aspekt do të thotë që duhet të jemi vërtetë shumë të kujdesshëm.

Së dyti, çështja e ligjit të Gjendjes Civile vjen sot si një ndërhyrje e pjesshme. Në fakt, ka raporte të një sërë organizatash ndërkombëtare dhe institucionesh ku Shqipëria është pjesë, Këshilli i Europës, EKRI dhe Raport Progresi i BE-së, që tregojnë se ligji i Gjendjes Civile ka probleme serioze në drejtim të arritjes, të respektimit të standardeve bazë të të drejtave të njeriut. Zgjidhja që propozohet është pa diskutim e nevojshme, por nuk i zgjidh problemet e tjera që ka ky ligj.

Në këtë aspekt ne do të rekomandonim sinqerisht dhe jemi gati ta mbështesin procesin që ky ligj të diskutohet haptazi me shoqërinë civile, jo thjeshtë në këtë tryezë, të përfshijë të gjithë ekspertët e çështjeve të të drejtave të fëmijëve, e ligjeve civile e të tjera. Po nisem nga një fakt i thjeshtë dhe kjo vlen për të gjithë qytetarët. Në qoftë se lexojmë ligjin e Gjendjes Civile, “regjistrimi i fëmijës”, fëmijës në lindje nuk i regjistrohet seksi, regjistrohet gjinia, që do të thotë, për ata që mbase nuk e kuptojnë, gjinia është një konstrukt social, formohet me kohë dhe përgjithësisht gjinia e personit, ajo që ne e kemi që të gjithë, shumica, të paktën 90% e popullsisë, ka një gjini që quhet “binare”, mashkull ose femër, na konfirmohet kjo gjini që në lindje. Për një pjesë të shoqërisë kjo gjini formohet e ndryshme nga ajo që është në realitet, që flasin për dy lloj çështjesh.

E para, personat transgjinatorë, të cilëve nuk u përputhet gjinia e seksit.

E dyta, personat interseks, të cilët sot e kësaj dite nuk regjistrohen nga mjekët, raporti që jep mjeku përkatës i lindjes, sepse në fakt Shqipëria nuk njeh atë që quhet seksi i tretë, gjinia e tretë që mund të ishte një “T” për “Tjetër”, diçka që mund të jetë fluide, e papërcaktuar, ose do të përcaktohet një moment kur vjen koha. Në këtë aspekt të gjitha rekomandimet e OBSH-së dhe të shumë organizatave të tjera tregojnë se në rastet e fëmijëve interseks është krim të bësh një operacion tek ata për t’ju përcaktuar seksin e tyre, sepse qëllon që kur arrijn moshën e pubertetit seksi i zgjedhur nga prindërit, jo nga vetë fëmija nuk përputhet me gjininë e personit.

Në këtë aspekt ne do të kërkonim që në mënyrë serioze të merren në shqyrtim të gjitha propozimet. Ne i kemi tonat gati. Nuk është momenti këtu që t'i prezantojmë, sepse jemi mbledhur vetëm për çështjen e regjistrimit të fëmijëve, por rekomandimi ynë do të ishte ta hapni këtë diskutim, sepse jemi në kohë. Ligji nuk ka kaluar në parlament, tani po fillojnë diskutimet dhe që të mos i kthehemi ligjit me ndryshimet sot, nesër apo pasnesër, hajdeni t'i bëjmë të gjitha në të njëjtën kohë!

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Po.

**Denisa Daka** - Unë e përgëzoj këtë tryezë, sepse është e domosdoshme, ndryshimet e ligjit gjithashtu janë të domosdoshme. Unë do të sugjeroja që grupet e interesit të jenë në çdo tryezë, pasi këto ligje të rëndësishme kanë nevojë për mendimet e ekspertëve. Unë personalisht dhe kolegët e mi, nuk i kemi këto ftesa dhe sugjeroj që të jemi në tryeza të tilla.

Lidhur me ligjin përkatës, përgëzoj të gjitha ndryshimet, por kam dy momente që duhet t'i sqarojmë së bashku me dy komente. Duke qenë se ndeshemi me praktikën, unë do të kërkoj një sqarim nga grupi i punës, se si do të bëhet me fëmijët që janë krejtësisht pa dokumente, që vinë nga jashtë pa dokumente? Përgjithësisht fëmijët që lindin jashtë shtetit vijnë pa dokumente dhe rezultojnë pa asnjë dokument, vite me radhë nuk arrijnë të regjistrohen në gjendjen civile. Si do të bëhet me fëmijët që regjistrohen me emrat e pagëzimit dhe jo me emrat e vërtetë? Edhe kjo ka qenë një hantikap që nuk ka lejuar dhjetëra fëmijë të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile. Janë probleme të mprehta, shumë të rënda që në fakt, nuk po marrin zgjidhje prej 25 vjetësh.

Më falni, sepse sot i kam marrë materialet dhe i pashë ndoshta jo me kujdes! Me sa shikoj kjo kategori nuk është përfshirë në këtë ndryshim dhe nëse nuk përshihet ky ndryshim që unë e konsideroj të rëndësishëm dhe themelor, për mua këto ndryshime, kjo paketë është mangët dhe nuk do të zgjidhë punë.

Faleminderit!

**Vangjel Kosta** – Edhe Viktori e tha në fillim, që ne kemi marrë të gjithë eksperiencën e TLAS-it dhe të gjitha organizatave të tjera që kanë pasur çështje në lidhje me regjistrimin e fëmijëve dhe jemi munduar t'i grupojmë në mënyrë të tillë që ligji të krijojë mundësinë që të mos mbetet asnjë fëmijë pa regjistruar. Meqenëse pyetjet janë konkrete, po përgjigjem në mënyrë konkrete.

Ne jemi përpjekur të zgjerojmë juridiksionin e gjykatave shqiptare për regjistrimin e fëmijëve që kanë dokumente të pasakta, që do të thotë se vërtetimi i faktit të lindjes së një fëmije pa dokumente është zgjidhur edhe më parë. Dyshimi mund të ketë qenë më parë në disa

nga gjykatat, ne kemi pasur përvoja. Nëse juridiksioni i gjykatave shqiptare shtrihet vetëm për fëmijët e lindur në Shqipëri apo dhe jashtë Shqipërisë, mënyra sesi është formuluar dispozita e sotme e shuam këtë dyshim. Unë besoj se në praktikë... nuk do të ketë shqetësime për këtë kategori të fëmijëve. Prindi që e ka pa dokumente duhet të provojë këtë fakt, ashtu siç do të provonte edhe po të ishte në Shqipëri, minimalisht ADN-ja do të ishte një provë më se e mjaftueshme në raste të tilla.

Për sa u përket emrave të pasaktë, kemi pasur raste, Viktori e trajtoi gjerësisht, me shtetin grek, sipas së cilit dokumentet e lindjes në gjendjen civile vinin pa emrin e fëmijës. Ne kemi rreth 80 çështje në trajtim e sipër dhe meqenëse çështjet gjyqësore për to, natyrisht, zgjasin. Është parashikuar mundësia që kjo çështje të zgjidhet në rrugë administrative. Nëse emri ekziston, por është i pasaktë, nuk besoj se cenon thelbin e aktit të lindjes. Akti i lindjes le të jetë i transferueshëm saktësisht në gjendjen civile të Shqipërisë, mjafton të ketë të dhënat e ashtuquajtura natyrore të lindjes, që lidhen me vetë lindjen, identitetin e nënës, kohën dhe vendin e lindjes, si dhe me gjininë e fëmijës.

Për sa i përket emrit, është një rubrikë e ndryshueshme. Besoj që nëse do të ketë vërtet vështirësi të kësaj natyre, të emrave të ndryshëm të pagëzimit nga emri i parashikuar nga prindërit, natyrisht që akti i deleguar për ministrin përkatës, për rastin e emrit, është i mjaftueshëm si bazë ligjore për ta zgjidhur këtë situatë.

Faleminderit!

**Denisa Daka** – Mund të bëj një replikë të vogël, ju lutem?

Po në rastet kur prindërit kanë vdekur dhe fëmija vjen në Shqipëri vetëm me të afërmit e tij? Ka disa raste, kur prindërit kanë vdekur në aksident dhe nuk ka mundësi të bëhet ADN-ja. Pra, si do të zgjidhet ky rast, kur vjen një fëmijë me të afërmin e tij në Shqipëri? Ky është një handicap. Janë dhjetëra raste, sidomos nga jashtë, që vijnë në këtë formë.

Faleminderit!

**Vangjel Kosta** – Për këtë çështje, besoj se zgjidhja është te zgjerimi që u është bërë në këtë ligj kategorive të atyre që mund të bëjnë deklarin e lindjes. Kur bëhet fjalë për paraqitjen e kërkesës në gjykatë, është parashikuar që jo vetëm prindi mund të shkojë në gjykatë, por mund të shkojë çdo subjekt që ka të drejtë të bëjë deklarin, pra përfshirë edhe institucionet shtetërore. Unë besoj se ky zgjerim i legjitimitetit të personave që mund të iniciojnë procesin, do të mbulonte edhe këto raste që u paraqitën.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Ka pyetje tjetër? Komentë?

Urdhëroni!

**Eglantina Gjermeni** - Faleminderit, Kryetar!

Kam vetëm një koment të shkurtër.

Së pari doja të përgëzoja shumë TLAS-in dhe ekspertët, që na japin një ndihmë të jashtëzakonshme për të zgjidhur apo për të adresuar problemin e regjistrimit të fëmijëve, por edhe për ta institucionalizuar më shumë grupin “Miqte e fëmijëve”!

Ne vërtet jemi një grup që bashkëpunon në mënyrë informale, por duke marrë nisma të tilla ligjore me impakt të jashtëzakonshëm, jo vetëm që zgjidhim problemet, por krijojmë një model praktike shumë të mirë për të gjitha grupimet e tjera dhe për ta vazhduar këtë traditë të mirë që Kryesia e Kuvendit ka filluar, duke pasur tryeza të tilla me të gjithë aktorët.

Për të thënë të drejtën, u ndjeva shumë mirë duke iu parë të gjithëve bashkë në një tryezë dhe që po diskutojmë për një iniciativë të kaq të rëndësishme. Them se kjo traditë e mirë duhet të vazhdojë duke dëgjuar të gjithë aktorët. Ne mundohemi ta vazhdojmë këtë traditë në komisione, por në të tilla përmasa jo. Kështu që kam vetëm vlerësime dhe ju uroj suksese!

Patjetër, në komisione do të diskutohet dhe do të ketë komente dhe sugjerime, por them se është një model shumë i mirë pune.

Ju falënderoj dhe ju përgëzoj sërish!

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Tjetër?

Urdhëro!

**Nora Malaj** – Në vijimësi të fjalës së koleges sime, edhe unë dua të falënderoj organizatorët dhe të gjithë ata që punuan shumë seriozisht! Ne arritëm që si grup të mbajmë premtimin e dhënë në fundin e seancës së sesionit të kaluar dhe rifillimin e sesionit të ri.

Ajo që doja të bëja me dije lidhet me faktin se për të gjitha problematikat që do të shfaqen, të dala nga kjo tryezë e rrumbullakët dhe nga grupi i ekspertëve, të gjitha aktet nënligjore mund të bëjnë rregullimin apo mund të krijojnë mundësinë e hapësirave për ato *gap*-e, duke pasur parasysh edhe disa nga ndryshimet, që mund të jenë të tilla që nuk kanë nevojë për rifinitura të veçanta. Mundet që aktet ligjore në hartim (besoj se grupi do t'i ketë parasysh edhe sugjerimet tuaja) t'i bëjmë më të plota, në mënyrë që me të vërtet t'u japim zgjidhje problematikave, që janë sa ligjore, aq edhe sociale, aq edhe në drejtim të të drejtave të njeriut.

Mendoj se është një punë shumë e mirë, ashtu siç tha edhe Tina, që së bashku, mbas kësaj nisme, të bëjmë edhe disa nisma të tjera në drejtim të disa prioriteteve të tjera, për sa i përket problemeve të fëmijëve, duke parë qasjen e propozimeve të Altinit, propozimet që kanë ardhur edhe për ndërtimin e një institucioni të ri, siç është “Familja dhe fëmijët” (në mos gaboj), si dhe për vazhdimin e parandalimit të bullizmit, që është një element tjetër po kaq i

rëndësishëm, që mund të jetë një nismë në vijimësi e këtij grupi, i cili mund të realizojë edhe raportet ligjore, mund të japë edhe interesa në drejtim të aksioneve kombëtare, por mund të kapë edhe problematikat e kohës, të cilat sot janë shumë të rëndësishme për t'u zgjidhur nga ministritë e linjës, por edhe nga ligjet që do të hartojmë së bashku.

Edhe një herë, shumë faleminderit dhe shumë suksese në vijimësi të zbatimit të këtij ligji shumë të rëndësishëm!

**Gramoz Ruçi** – Unë i përgëzoj deputetët për praninë, për mbështetjen e problemit dhe zgjidhjen, sepse janë ata që do të vënë firmën te nisma, janë ata që do ta diskutojnë te Komisioni i Ligjeve dhe ata që duhet ta bëjnë këtë projektligj në sallën e Kuvendit, por duke u treguar gjenerozë dhe duke qenë se tavolina është e gjerë, do t'ju lutesha, që ne si firmëtar ose diskutues të këtij projektligji, ose si votues të këtij projektligji, do të ishim shumë të interesuar nëse partnerët tanë të organizatave ndërkombëtare do të kenë ndonjë sugjerim për këtë çështje, dhe së dyti, OJQ-të e ftuara këtu dhe që janë me shumicë, nëse kanë problem për këtë çështje, ta thonë me qëllimin që deputetët ta kenë në qendër të vëmendjes qoftë përmirësimin e nismës, qoftë edhe miratimin e nismës. Ne deputetët do të jemi ata që do ta miratojmë kështu që të mos flasim ne, por veçanërisht këto dy kategori.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit!

Falënderojmë ekspertët e TLAS-it që shqetësimi që u ngrit në raportimin që u bë në mbledhjen e mëparshme, u bë realitet brenda afatit.

Unë kam dy pyetje lidhur me formulimin që i bëhet nenit 41, ku shtohet një pikë për referimin e fëmijëve të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. A gjejnë zgjidhje rastet kur prindërit u vënë fëmijëve dy emra, ose fëmija ka dy mbiemra dhe kur për fëmijën që jeton jashtë vendit prindi vjen për ta regjistruar në regjistrin e gjendjes civile shqiptare? Në dijeninë time ka probleme dhe shpesh kemi marrë edhe ankesa kur u thua të zgjedhësh një nga emrat. Vënia e dy emrave ndodh në Francë, për shembull Zhan- Pol, ku ka edhe emrin e gjyshit, ose në Greqi kur ka edhe emrin e pagëzimit, për shembull, Ana Maria, ose një emër tjetër.

Mua më vjen mirë që është rregulluar problemi i regjistrimit të fëmijëve në rastet kur të dy prindërit nuk e bëjnë deklarin brenda 60 ditëve, dhe regjistrimi bëhet në mënyrë aktive nga institucionet, por në rast kur nëna e lind fëmijën dhe pastaj e braktis që në maternitet ose e lë aty dhe ikën, si do të bëhet regjistrimi i fëmijëve?

Në riformulimin e nenit përkatës thuhet se nëse brenda 60 ditëve nga data e lindjes nuk bëhet regjistrimi në gjendjen civile, atëherë kush do ta bëjë regjistrimin kur nëna kërkon totalisht ta braktisë dhe nuk jep as emrin e babait?

**Vangjel Kosta** - Lidhur me braktisjen, unë besoj se nuk kemi pasur shqetësime, sepse për braktisjen ligji ka qenë më i qartë. Ajo që mungonte në ligj ishte braktisja nga regjistrimi, jo braktisja në prindërim, sepse ligji ekzistues parashikonte shprehimisht rregulla të posaçme se çfarë ndodh kur nëna braktis fëmijën dhe ngarkon institucionet shtetërore që ta bëjnë regjistrimin me dokumentin që ka mbajtur institucioni i lindjes në momentin e lindjes.

Unë besoj se zgjerimi që ne i bëjmë këtij koncepti që, përveç fëmijëve të braktisur të përfshijmë edhe fëmijët që, në fakt, mbahen pranë prindit, por braktisen në kuptimin ligjor, sepse nuk realizohet regjistrimi, mbulojnë një gamë më të gjerë rastesh dhe natyrisht e ripërfshijnë edhe rastin që ju propozoni.

Sa i përket pyetjes së parë, përgjigjja mund të vijë jo e drejtpërdrejtë. Ajo që ne na ka munduar është dokumenti i mbajtur në gjendjen civile të një shteti tjetër, në pamundësi për t'u regjistruar në gjendjen civile të Republikës së Shqipërisë. Ky është shqetësimi. Pse nuk bëhet transkriptimi i regjistrimit, sepse ka si rregull mospërputhje të të dhënave të prindit pranë të cilit do të regjistrohet, ose dokumenti i lindjes përmban të dhëna që vijnë në mospërputhje me parashikimin e ligjit shqiptar. Pak a shumë, rasti që ju përmendët është ky i dyti, pra ligji shqiptar nuk parashikon rubrika shtesë dhe për rrjedhojë dokumenti i mbajtur në shtetin tjetër bëhet i pamundur për t'u transkriptuar në regjistrin e gjendjes civile shqiptare. Rregulli që ne kemi propozuar që në të tilla raste gjykata shqiptare të certifikojë lejimin e përdorimit të këtij dokumenti për efekt regjistrimi, që do të ishte niveli i fundit që do të mbyllte çdo shqetësim. Ndërkohë, një pyetje me vend që mund të lindë është a duhet ta rishikojmë, edhe Altini e tha këtë, nëse në ligj ka vend për ndërhyrje të tjera për të zgjeruar mbajtjen e më shumë se një mbiemri ose të dhëna të tjera të shtuara. Unë besoj se ky është një shqetësim që nuk ka të bëjë me regjistrimin, por ajo që na ka shqetësuar është e drejta superiore, regjistrimi i fëmijës. Natyrisht, të drejta të tjera, siç mund të jetë edhe kjo që unë dua të mbaj më shumë se një mbiemër apo shumë të drejta të tjera, të cilat nuk po i përmend, që mund të vijnë si regjistrim, natyrisht mund të jenë probleme për t'u zgjidhur, por ne jemi fokusuar te zgjidhja e problemit kryesor që asnjë fëmijë të mos mbetet i papërfshirë në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe besoj se kjo është zgjidhur.

**Altin Hazizaj** – Falënderoj profesoreshë Vasilikën, që e ngriti si çështje!

Unë do të theksoja dy momente kryesore.

E para, çështja e emrit dhe e mbiemrit. Në ligj nuk thuhet që ndalohet të kesh dy emra dhe mbiemra, ligji thotë se çdokush ka të drejtë të ketë një emër dhe një mbiemër, por ai emër mund të jetë i përbërë edhe nga disa emra të tjerë dhe ligji nuk e cakton këtë gjë, apo jo? E njëjta gjë vlen edhe për mbiemrin. Ajo që vlen të theksohet është që praktika e punës në

Gjendjen Civile nuk e ka pranuar momentin kur ka pasur dy, tre apo katër emra, siç mund të ketë prindër që duan t'u vendosin fëmijëve të tyre emër me katër prapashtesa. Kjo është thjesht çështje praktike.

E dyta, ligji kërkon që regjistruesi kryesor i Gjendjes Civile, që është në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka të drejtë dhe për detyrë të publikojë listën emrave të përshtatshëm. Pra, bëhet fjalë për emra të përshtatshëm, por jo për emra specifike në numër. Unë shoh pak me shqetësim çështjen e regjistrimit të fëmijëve në zyrat konsullore të Shqipërisë, sepse Zyra Konsullore është një element i ndërmjetëm. Në fakt, regjistrimin e bën Zyra e Gjendjes Civile, e cila mund të vendosë, kjo është çështje procedurale, në këtë ligj që zyra mund të pranojë dokumentacionin dhe ta njoftojë automatikisht zyrën përkatëse në Ministrinë e Brendshme ose Regjistrin Kombëtar të Shtetasve. Për ta zgjidhur këtë si ngërç mund të gjenden teknikalitete.

**Gramoz Ruçi** – Kush e do fjalën?

A ka mendime?

**Toni Gogu** – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit!

Ju falënderoj për nismën dhe në emër të Ministrisë së Drejtësisë doja të bëja një sqarim shumë të thjeshtë për ju, për gjithë deputetët e nderuar, si dhe për të gjithë pjesëmarrësit në tryezë, për shkak se zoti Gumi ngriti një çështje shumë delikate që kishte të bënte me ndihmën juridike.

Me gjithë sistemin e ndihmës juridike, meqenëse kemi miratuar një ligj të ri dhe Ministria e Drejtësisë ka punuar me shumë seriozitet, me ekspertizë vendase dhe të huaj dhe jemi në fazën përfundimtare të ndërtimit skemës, unë thjesht doja t'ju informoja ju dhe të gjithë pjesëmarrësit që në javët dhe në muajt në vijim do të shohim se si kjo skemë do të fillojë të funksionojë. Është një skemë e ndërlikuar mbi të cilën kemi nxjerrë mësim nga e kaluara, por, gjithashtu, jemi përpjekur ta ndërtojmë me sistemet bashkëkohore të ndihmës juridike.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit!

A ka ndonjë tjetër që e do fjalën?

**Mira Rakacolli** – Unë jam përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale. Duke marrë shkak nga vërejtja që bëri zonja Hysi, për mënyrën se si do të procedohet për regjistrimin e fëmijës nëse prindi e braktis ose nuk shkon në Zyrën e Gjendjes Civile brenda 60-ditëve, po punojmë për një modalitet që fëmija menjëherë pasi të lindë të regjistrohet direkt nga institucionet e kujdesit shëndetësor qofshin publike apo private.



Më pas ky informacion të hidhet direkt dhe të aksesoret në *e-Albania*. Pra, jemi duke punuar me AKSHI-n që të kalojë direkt në *e-Albania* dhe në këtë mënyrë fëmija do të rezultojë i regjistruar edhe nëse prindërit nuk do të paraqiten për ta bërë atë. Pra, këtu duhet një lloj riformulimi.

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit!

A e dëshiron ndonjë tjetër fjalën?

**Nejla Peka** – Jam Komisionere për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, institucioni i Avokatit të Popullit.

Së pari, dua t'ju shpreh falënderimet për ushtrimin e iniciativës për ndërmarrjen e propozimeve për ndryshimin e ligjit për gjendjen civile. Institucioni i Avokatit të Popullit në trajtimin e ankesave konkrete dhe kërkesave në bashkëpunim me TLAS-in ka hasur vazhdimisht me këtë problem për fëmijët në rrezik shtetësie apo pa shtetësi. Ajo çka do të doja të theksoja është fakti lidhur me atë kategori shtetësie shoqërore, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të realizuar një procedurë të tillë regjistrimi. Kryesisht në objektin e ankesave që ne kemi trajtuar me TLAS-in kanë qenë raste konkrete që lidhen me pamundësinë ekonomike të prindërve për të regjistruar fëmijët, kryesisht lidhur me testin e ADN-së. Në këtë drejtim në vijim edhe të asaj çka tha zëvendësministri i Drejtësisë, për kuadrin e ri ligjor për ndihmën juridike, ndoshta do ta shikoni me vend reflektimin në referencë të këto ndryshime ligjore për këtë kategori shoqërore që është në pamundësi ekonomike të kryerjes së kësaj procedure.

Ndërkohë, kam edhe një pyetje tjetër, e cila lidhet me shtimin e dispozitës, konkretisht neni nr. 41/1, për raportimin dhe regjistrimin e lindjeve me procedurë të veçantë. Nëse do t'i referohemi ligjit bazë në nenin ku përmenden përkufizimet kryesore në kuptim të këtij ligji, unë nuk e pashë, në fakt, përkufizimin e termit “Lindje me procedurë të veçantë”. Në këtë rast, pyetja ime është: çfarë keni pasur parasysh? Mos ndoshta do të ishte mirë që edhe te përkufizimet të referohet diçka lidhur me këtë procedurë?

Faleminderit!

**Viktor Gumi** – Faleminderit!

Në lidhje me këtë pjesë, dedikimi që kemi posaçërisht për procedurën e veçantë fillon dhe mbaron te neni 41/1. Vlerësuam dhe gjykuam që, përderisa ky element është i shtjelluar vetëm në një nen dhe nuk ka indikacione apo influenca në nene të tjera, pra posaçërisht për regjistrin e përkohshëm, te neni i përkufizimeve nuk mund të shtojmë “çfarë kuptojmë me procedurën e veçantë”. Si rregull, te fjala e përkufizimeve vendosen dispozita që përdoren dhe përkufizohen më shumë se një herë në tekstin e ligjit.

Regjistrin e përkohshëm e kemi filluar dhe mbaruar vetëm te neni 41/1, prandaj edhe për të mos krijuar nga dëshira më tepër inflacion të dispozitave ose përmbajtjes normative, gjykuam dhe vlerësuam se fillimi, mbarimi i procedurës së veçantë vetëm në një nen ezauron qëllimin që të mos shtrihen edhe në indikacione në nene të tjera.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Kush e dëshiron fjalën?

**Rajmonda Bozo** – Do të doja t’i jap një përgjigje komisioneres lidhur me problemin që kanë grupet vulnerabël kur ato duhet të paraqiten në gjykatë, dhe kjo e fundit kërkon analizën e ADN-së.

Do të doja ta filloja me shumë falënderime, por po e filloj direkt për të dhënë sqarime dhe po e lë në fund falënderimin për gjithë këtë tryezë të rëndësishme.

Meqë më erdhi rasti do të doja të them diçka, pasi e kam shumë me merak: donatorët, të cilët ndodhen sot në këtë tryezë, UNHCR-ja dhe UNICEF-i, por jo vetëm, kanë kontribuar në mënyrë të ndjeshme në mbulimin e kostove të analizës së ADN-së për qytetarët që kanë nevojë. Kjo është një ndihmë shumë e madhe, por nuk është e përhershme, ndaj shteti do të duhet të parashikojë t’i përjashtojë kostot e kësaj analize të kushtueshme për të ardhmen.

Po hyj në një terren shumë konkret: ne si zyrë kemi mbuluar për një vit, le të themi, 60 fëmijë dhe këta i kanë siguruar një laborator privat me një tender që do të na jepte një çmim sa më optimal. A e dini sa është çmimi në Laboratorin e Ministrisë së Brendshme për një ADN? Është jashtëzakonisht e madhe dhe e papërballueshme. Nuk e di sesi do të jenë modalitetet për ta zgjidhur, sepse po flasim për një terren praktik, në mënyrë që të përjashtohen dhe të mos kemi këto kosto. Shkon deri në 800 mijë bashkë me TVSH-në.

Meqenëse sot kemi të ftuar edhe kolegët e Ministrisë së Brendshme, do të doja që edhe për këtë, të mund të gjejmë mënyrën sesi do të mbulohen kostot e ADN-së për rastet e veçanta, të cilat, në vit, mund të jenë 50, 60.

Vetëm këtë do të doja të thosha, zoti kryetar, megjithëse do të doja ta merrja edhe një herë fjalën në fund për dy minuta, jo më tepër.

Faleminderit!

**Denisa Daka** – Më lejoni të mbështes zonjën Rajmonda. Këto janë praktikat në gjykatë. Edhe në rastet e ndihmës juridike palët përfaqësohen falas, por përjashtohet në çdo rast akti i ekspertimit, ai i psikologut, dhe ai i ADN-së. Kjo e bën zgjidhjen e pamundur në shumë raste. Pra, duhet rregulluar edhe kjo pjesë në mënyrë që të përfitojnë falas të gjithë procedurën, ndryshe këto praktika do të mbeten përgjysmë dhe nuk do të gjejnë zgjidhje.

Faleminderit!

## **Klotilda Bushka – Faleminderit të gjithë ekspertëve!**

Kam një pyetje për sa i takon pjesës së ndihmës juridike që do t'u jepet dhe ofrohet subjekteve përfituese nga ky ligj. Për të sqaruar të gjithë opinionin publik në lidhje me ndihmën juridike me ligjin e ri gjithë ky sistem i ri i krijuar nuk ka të bëjë vetëm me pagesën e avokatit.

Sipas ligjit të ri të ndihmës juridike, i cili është miratuar në fillim të këtij viti dhe ka hyrë në fuqi më 1 qershor 2018 dhe shumë shpejt pritet të dalin aktet nënligjore për zbatimin efektiv të tij, ndihma juridike që u jepet kategorive në nevojë dhe atyre kategorive përfituese të veçanta përbëhet nga: shpenzimet për mbrojtjen juridike për avokatin, shpenzime gjyqësore ku përfshihen edhe shpenzimet e aktit të ekspertimit, madje edhe duke i kombinuar edhe ligjin e ndihmës juridike me ligjin për tarifën gjyqësore, këto subjekte janë të përjashtuara edhe nga taksa e padisë, edhe nga taksa e ekzekutimit të vendimit nëse do të jenë gjyqfitues.

Ky është parashikimi që kemi bërë në ligjin e ndihmës juridike ku kam qenë vetë relatore dhe i kemi parashikuar e zeza në të bardhë.

Pyetja që kam: duke qenë se do të kemi kategori përfituese, nga dispozitat që jeni duke prezantuar këtu dhe që ne do t'i mbështesim, a do të duhet të shtohet në projektpropozimin tuaj fakti që subjekte, të cilat kanë nevojë të mbështeten në këtë drejtim, do të kenë mbështetjen sipas parashikimit të ligjit të ndihmës juridike, apo mendoni që është e mjaftueshme ajo që është parashikuar në ligjin e ndihmës juridike?

**Viktor Gumi** - Teknikisht mund të realizohet një gjë e tillë dhe nuk kemi kundërshtime, sepse në fund të ditës përsëri duhet të jetë një dispozitë referuese, e cila nuk do të krijojë të drejta dhe detyrime, por do t'i referohet në dispozite tjetër të një ligji tjetër. Ekzistenca ose mosekzistenca e saj nuk parashikon vlefshmërinë dhe zgjidhjen e situatës konkrete, sepse ai është një ligj kuadër, që rregullon fushën e caktuar.

Shqetësimi ynë i vetëm, që ngritem edhe në pjesën hyrëse të saj është: kjo është një procedurë, e cila edhe pa këtë ligj, por më tepër me këtë ligj, do të kërkojë medoemos dy komponentë.

Komponenti i parë është ndihma juridike, sepse, si shembull, ne morëm shtesat më në nevojë.

Së dyti, ne i diskutuam edhe ato dilemat teknike, ndryshim dhe diskutim të trajnimit të gjyqtarëve, sepse ka ndryshim të menjëhershëm të mentalitetit dhe të zgjidhjes së çështjeve brenda dy-tre çështjeve të caktuara. Ajo që presim dhe kërkojmë është: shpejtësi dhe alokim të buxhetit. Në asnjë moment shteti shqiptar nuk mund të nxjerrë këndvështrimin dhe të thotë se ka mungesë lekësh për të ofruar ndihmë juridike, se nuk ka krijuar institucione për të ofruar ndihmën juridike dhe se nuk i respektoji afatet kohore për të ofruar ndihmën juridike. Ndhma

duhet të jetë praktike dhe teorike. Përballë gjykatave ndërkombëtare justifikimi se nuk ka krijuar institucione nuk merret parasysh, justifikimi se nuk ka fonde përsëri nuk merret parasysh.

Prandaj, ne gjykuam dhe vlerësuam që ta sjellim në vëmendje sa më shpejt, aq më mirë, nuk bëjmë dot të pamundurën apo ekselentën, por dy hapa duhen hedhur për të dhënë edhe mesazhin se ndihma juridike nuk është më në kolaps.

**Gramoz Ruçi** – Kush tjetër e do fjalën?

**Ulsi Manja** - Kryetar, dua të bëj një sqarim të vogël për ligjin e ndihmës juridike. Në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji buxheti i vënë në dispozicion nga qeveria, si faturë financiare për zbatimin e këtij ligji, ka qenë 500 milionë lekë të vjetër ose 50 milionë lekë të rinj për vitin 2018 për 6 muaj. Ndërsa në projektbuxhetin e vitit 2019 fatura financiare për ligjin e ndihmës juridike do të jetë ndoshta shumëfishuar disa herë. Ky ka qenë kushti i vendosur për miratimin e këtij ligji, që buxheti i vënë në dispozicion të jetë i disbursueshëm, sepse ky ligj ka qenë në fuqi, por ka qenë i pashoqëruar me një fond përkatës. Këtë gjë e pashë të nevojshme ta sqaroja, sepse edhe ky projektligj që propozohet është i lidhur me ligjin e ndihmës juridike.

Në fakt, edhe sipas prezantimit që bëri zoti Gumi, ky ligj synon të zgjidhë vetëm një situatë, që ka të bëjë me regjistrimin e fëmijëve të lindur nga prindër shqiptarë, por me banim të përhershëm jashtë Shqipërisë, si dhe rastin e regjistrimit të fëmijëve, të cilët banojnë në Shqipëri, por nuk u dihen prindërit, ose prindërit u kanë vdekur ose prindërit nuk kanë interes për të bërë regjistrimin. Natyrisht, kjo nismë ligjore duhet të jetë komplementare me të gjithë kuadrin ligjor që kemi në fuqi, sepse këtu me të drejtë u shtruan disa pyetje, që kanë të bëjnë me emrin e dytë, por edhe me pasjen e mbiemrit të dytë e kështu me radhë. Problemi lidhet me përbërësit e regjistrimit të gjendjes civile, sepse ky ligj ka shumë rëndësi të diskutohet gjerësisht edhe nga deputetët në Komisionin e Ligjeve, sepse afekton edhe përbërësit zgjedhorë. Unë e vlerësoj këtë nismë.

Kjo nismë është me procedurë të përshpejtuar dhe në dijeninë time është caktuar data 11 tetor për ta kaluar në seancë plenare. Kështu, ngelet që javën e ardhshme Komisioni për Çështjet Ligjore ta fusë në rendin e ditës këtë projektligji për ta miratuar në parim, për ta shqyrtuar nen për nen dhe më pas për ta miratuar në tërësi, në mënyrë që në datën 11 tetor, sipas vendimit, ta kalojmë në seancë plenare.

Faleminderit!

**Elisa Spiropali** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit të gjithëve dhe posaçërisht ekspertëve!

Zonja Rakacolli përmendi faktin që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka një program për të lidhur të paktën të dhënat në spitale apo qendrat shëndetësore me gjendjen civile. Unë nuk e di nëse janë të lidhura aktualisht apo nëse ka ndonjë sistem referimi në gjendjen civile. Njëkohësisht, zoti Gumi, kur prezantoi projektin, cilësoi se në nenin 40, pika 2, të shtoheshin fjalët “njësitë për mbrojtjen e fëmijës”. Pra, në rastin kur regjistrimin e fëmijëve brenda 60 ditëve nuk e kryejnë personat e përcaktuar në pikën 1, atëherë do ta kryejnë njësitë për mbrojtjen e fëmijëve. A ka këtu një kundërshti? Ndoshta, nëse ne do të dimë afatet se kur Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mendon ta kryejë këtë projekt konsultimi që ka nisur, nëse ka një *data line*, më pas këto mund të lidhen. Nëse regjistrimi i tyre do të bëhet në spital, pastaj do të kalohet në gjendjen civile, ndoshta kjo e zgjidh çështjen për njësitë e mbrojtjes së fëmijës, të paktën për fëmijët e lindur këtu.

**Mira Rakacolli** – Aktualisht ne po punojmë me AKSHI-n. Të gjitha spitalet publike dhe ato private do të kenë një modul të veçantë që të plotësojnë në kohë reale dokumentin e lindjes te portali e–albania.al, prandaj do të regjistrohet...

**Elisa Spiropali** – Kur parashikohet që të futen në këtë sistem?

**Mira Rakacolli** – Ne po punojmë dhe nuk jam në gjendje të të them një afat të saktë kohor, por po them se do të jetë shumë shpejt.

**Gramoz Ruçi** – A ka ndonjë pyetje tjetër?

**Arjana Fullani** – Do t’i kthehem edhe një herë shqetësimit që prezantoi kolegja Qiriako, në lidhje me llojin e gjyqimit që kanë zgjedhur ekspertët, që është vërtetimi i faktit juridik. A është lehtësisht e zbatueshme kjo dispozitë e ligjit, pra a do të shkojnë lehtësisht qytetarët në zyrën e gjendjes civile me një vërtetim fakti juridik dhe t’i thonë më ndrysho emrin ose mbiemrin? Këtë e kam shumë merak, sepse jemi të gjithë prezent në histori që tregohen për burokracirat në zyra të ndryshme për të realizuar të drejtat e qytetarëve.

Do më kishte pëlqyer më shumë një gjykim tjetër, ku zyra e gjendjes civile të kishte një tjetër procedurë, të ishte e paditur dhe të kishte një vendim të zbatueshëm, sepse kemi thënë se vërtetimi i faktit juridik është një vendim deklarativ, a shkruhet dot në fund të vërtetimit që detyrohet zyra e gjendjes civile që të zbatojë ose që ta regjistrojë? E para.

E dyta, a ka ndonjë arsye të veçantë se përse bëhet vetëm ndryshimi i kaq pak neneve të ligjit për gjendjen civile, ndërkohë që situatat faktike që nuk gjejnë rregullim në ligj janë shumë më tepër se sa kaq? Pra, përderisa hyhet në një proces ndryshmi të ligjit të gjendjes civile, të ndryshohen të gjitha situatat që nuk gjejnë zgjidhje ligjore në ligj.

E fundit, përfitoj nga prania e donatorëve të huaj, që i falënderoj shumë për mbështetjen e iniciativave të tilla, por do të sugjeroja që ata të mbështesin të gjithë paketën, pra të na

prezantojnë një paketë ligjore, e cila do të jetë realisht e zbatueshme, siç mbështesin ligjin, të mbështesin edhe aktet nënligjore, të nevojshme, madje do të avancoja duke i sugjeruar që të mbështesin edhe një fushatë ndërgjegjësimi, e cila do të njoftojë qytetarët shqiptarë që jetojnë në shtete të tjera që është ndryshuar ligji dhe nuk kanë nevojë që të trokasin në 100 dyer, por procedura është në 1, 2, 3, 4.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Po, mund të flisni!

**Vangjel Kosta** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e kemi parë me kujdes edhe pjesën e zbatimit të këtyre parashikimeve ligjore. Kodi i Procedurës Civile, kur flet për vërtetimin e faktit, ka edhe një parashikim, ku personi i thirrur nga gjykata, si person i interesuar, ka detyrimin ta njohë faktin që vërteton gjykata. Kjo do të thotë që në momentin që në këtë gjykim thërritet si person i interesuar, zyra e gjendjes civile që do të ketë detyrimin që të bëjë regjistrimin, ka të drejtën të ankimojë vendimin nëse pretendon që faktet nuk po vërtetohen saktësisht, por nuk mund ta kundërshtojë vendimin pasi ky vendim është i formës së prerë. Në këtë pikëpamje ne besojmë që nuk duhet të ketë vështirësi praktike që këto vendime gjyqësore të zbatohen. Përfshirja e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në mënyrë të shprehur në këto ndryshime, besoj se do ta sensibilizojë atë zyrë që nëpërmjet akteve udhëzuese do të sqarojë zyrat e gjendjes civile, që në raste të tilla, ku ato janë thirrur si subjekt në një gjykim, vendimi i gjykatës, pavarësisht se është vendim i një lloji deklarativ të vërtetimit të faktit, nuk mund të refuzohet për t'u reregjistruar.

**Gramoz Ruçi** – A ka ndonjë pyetje tjetër? Nuk ka.

Unë kam një pyetje të fundit për drejtorin e gjendjes civile, me këtë projekt a zgjidhet problemi dhe shqetësimi që kemi?

**Bledar Doracaj** – Faleminderit!

Në diskutimet që kemi pasur edhe me specialistët e TLAS-sit në lidhje me draftin e paraqitur për ndryshimet ligjore, në radhë të parë shprehim dakordësinë dhe besojmë se do t'i japim përgjigje një numri të konsiderueshëm problemesh, por në fund do të ketë edhe raste ose çështje të cilat mund të mos marrin zgjidhje. Në objektin e punës që TLAS-i bën, duke ofruar ndihmë juridike për fëmijët pa shtetësi apo për fëmijët e pa regjistruar, pjesa më e madhe e këtyre problemeve do të marrin një përgjigje. Me miratimin e ndryshimeve dhe me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore besoj se do të jetë i aplikueshëm.

**Gramoz Ruçi** – Zonja Rajmonda thatë: në fund më jepni edhe një herë fjalën...

**Rajmonda Bozo** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Bashkë me falënderimet për ju personalisht dhe për deputetët e grupit “Miqtë e fëmijëve”, që për dy herë rresht i dhanë rëndësinë e duhur kësaj çështjeje, dua të falënderoj edhe disa nga institucionet shtetërore, duke përmendur në mënyrë të veçantë Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë për Europën dhe Punët me Jashtë, të cilat kanë përfaqësuesit e tyre sot këtu, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Diasporës, që, në fakt, do të duhej të ishte e para, më falni, por doli në fund, dhe t’i përgëzoj për faktin se sensibilizimi për çështjet e personave pa risk pashtetësie që na sollën te këto ndryshime ligjore, u kuptua gjatë vitit 2017 në mënyrën më të mirëkuptueshme apo më të ngrohtë prej tyre, duke vënë në dispozicion të gjitha qendrat shëndetësore, të gjitha drejtoritë arsimore dhe të gjitha zyrat e gjendjes civile për të identifikuar me emra, me moshë, me gjini dhe me adresa të gjithë personat në rrezik pashtetësie në Shqipëri, studim për të cilin ju keni dijeni edhe nga relacioni, edhe nga mbledhja e mëparshme.

Me këtë dua të shpreh mirënjohjen ndaj organeve dhe strukturave shtetërore, që në vitet e fundit kanë qenë të gatshme, duke përfshirë këtu edhe dy institucionet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut: Avokatin e Popullit dhe Komisionerin kundër Diskriminimit, për të bashkëpunuar në këtë çështje kaq të rëndësishme.

Ne erdhëm këtu thjesht për të evituar në mënyrë sa më të shpejtë faktin e personave në rrezik pashtetësie, sepse duke qenë edhe anëtarë të një *network*-u rajonal, po e ndiejmë shumë presionin, madje na vjen zor që në Shqipëri të kemi ende persona të kësaj kategorie.

Nëse do të vazhdojmë të punojmë në këtë mënyrë, ky rrezik nuk do të ekzistojë për shumë kohë.

Vetëm kaq kisha për të thënë.

Faleminderit, zoti Kryetar, si dhe të gjithë atyre që na kanë mbështetur!

**Pablo Zapata** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Me lejen tuaj, po vazhdoj në shqip, sado me shumë gabime, por ashtu le të bëjmë.

Së pari, ne vlerësojmë dhe falënderojmë ritmin e punës, sepse ka pasur angazhim që në takimin e parë dhe tani, pas pak kohësh, kemi takimin e dytë me një propozim konkret. Ne e vlerësojmë këtë si një angazhim konkret, pra jo vetëm me fjalë, dhe shpresojmë se pastaj do të kemi aktet ligjore dhe ato nënligjore, të cilat do të vijnë shpejt dhe në mënyrë eficiente jo vetëm nga Kuvendi i Shqipërisë, por edhe nga Ministria e Brendshme dhe ajo për Europën dhe Punët me Jashtë, me të cilat bashkëpunojmë çdo ditë.

Kam një koment për propozimin. Ne mendojmë se kjo është vërtet një lëvizje interesante nga shteti, pra shteti nuk qëndron mbrapa tavoline, por shkon dhe takon qytetarët, në një mënyrë aktive dhe efektive. Shpresojmë që ky ndryshim ligjor të lidhet me ndryshime

në praktikë, në mentalitet dhe në administratën në Shqipëri. Ne kemi bashkëpunuar në mënyrë shumë të ngushtë me Drejtorinë e Gjendjes Civile dhe kemi konstatuar që sjell ndryshime në mentalitet dhe jemi shumë të kënaqur për ta vazhduar këtë proces.

Në përfundim, dua të falënderoj zonjat dhe zotërinjtë deputetë për bashkëpunimin, si dhe kolegët e UNICEF-it për vendin që na kanë dhënë në këtë grup parlamentar, ku ne jemi angazhuar jo vetëm për ligjin, jo për vetëm aktet nënligjore, por do të vazhdojmë me ju deri në implementimin e ligjit dhe të akteve nënligjore!

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Për ta mbyllur, edhe një herë do të falënderoja veçanërisht organizatat ndërkombëtare që janë prezente dhe që kanë dhënë kontribut si në konkluzionet e arritura në mbledhjen e parë, ashtu edhe në produktin e takimit të sotëm që nga UNHCR-ja, UNICEF-i, PNUD-i, TLAS-i, si dhe të gjithë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, ku sot prezente janë 11 në total, ashtu sikurse edhe shtatë OJQ-të që janë prezent sot dhe kanë qenë edhe në takimin e kaluar, për kampionin së cilës i ranë që në fillim, të përcjella këto edhe në takimin e parë dhe sot, për të vijuar me përgëzimet më të mira për produktin që ekspertët përkatës sollën dhe na e prezantuan sot!

Që në fillim dua të nënvizoj se ne sot po bëjmë një përpjekje fundore për të konkretizuar një nismë ligjore, që të kthehet shumë shpejt në ligj brenda muajit, për t'i dhënë përgjigje dilemës së mjaft qytetarëve shqiptarë që jetojnë në Shqipëri dhe atyre që jetojnë veçanërisht jashtë, që është numër shumë i madh, të cilët vuajnë çështjen se kanë fëmijë, por nuk i regjistrojnë dot. Pra, për dilemën tuaj që vuani, zgjidhni vetë apo vrisni veten me mosregjistrimin e fëmijëve, shteti shqiptar kërkon t'i japë një zgjidhje ligjore këtij problemi për t'ju ardhur në ndihmë dhe për ta zgjidhur. Kështu, nëse unë i bëra një pyetje drejtorit të Gjendjes Civile, këtë s' duhet ta lëmë që pjesërisht e zgjidh dhe pjesërisht nuk e zgjidh, ose në pjesën dërmuese e zgjidh dhe rastet e veçanta nuk i zgjidh.

Në qoftë se do të bëjmë këtë ndryshim, ne duhet ta zgjidhim këtë çështje. Ky takim së bashku me takimin e parë është për të zgjidhur këtë çështje, që kjo çështje të mos ekzistojë më tek ne. Prandaj, do t'ju lutem deputetëve që nga të gjitha mendimet që u dhanë këtu, kjo të konsiderohet fillimi i dhënies së mendimeve dhe të asistencës së ekspertëve.

Për shembull, më tërhoqi vëmendjen ajo që zonja Fullani e artikuloi me dy fjali. Si një gjyqtare me shumë përvojë, ajo me ato dy fjali tha se qytetarët venë tek këta gjyqtarë dhe sjellin një tok problemesh, të cilat megjithë dëshirën dhe vullnetin e mirë për t'i zgjidhur, këtyre qytetarëve nuk u zgjidhet çështja. Atëherë, që kjo të bëhet sa më aplikueshme, mund të



pasurohet qoftë në projekt e veçanërisht, në aktet nënligjore që ai qytetar, që e vuan (janë 5000-6000-10000 fëmijë dhe askush nuk e di numrin e saktë), që problemi i tij të zgjidhet.

Që ky problem të zgjidhet kërkon në radhë të parë që ne ta perfeksionojmë dhe ta bëjmë sa më konkrete dhe të aplikueshme, jo burokratike këtë nismë.

Po ashtu, kërkon që aktet nënligjore të dalin menjëherë dhe të jenë në shërbim të ligjit, kërkon një fushatë të madhe ndërgjegjësimit në këtë çështje, duke i bërë jehonë kësaj nisme, këtyre masave me qëllim që ky problem i këtij numri të konsiderueshëm fëmijësh, të gjejë zgjidhje. Po ashtu, kërkohet një asistencë, siç tha zotëria te gjyqtarët, te punonjësit e gjendjes civile, që të thonë: ke këtë apo nuk ke atë dhe ik!

Ky ishte problemi i parë, që kisha.

Problemi i dytë, që më tërhoqi vëmendjen, janë aktet ligjore.

Zotërinj deputetë, 1 nga funksionet bazë që ka Kuvendi është kontrolli mbi ekzekutivin. Këtë e kam për vete dhe për ju. Kontrolli për zbatimin e ligjit ka shumë gjëra, por mbi të gjitha, në çdo ligj ne vëmë detyrimin të nxirren akte nënligjore brenda një afati.

Është e detyrueshme nëpërmjet kontrollit parlamentar, qoftë edhe nëpër seancat parlamentare të bëjmë një bilanc për çdo ministri, për të gjitha projektligjet që kemi miratuar, kush dhe çfarë është bërë me aktet nënligjore. Këto t'i trajtojmë qoftë në seancë parlamentare, qoftë në komisionet parlamentare. Prandaj, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore të mos ndodhen gafil nesër, qoftë para komisioneve të Parlamentit të Shqipërisë, qoftë ndaj seancës parlamentare.

Pa i mërzhitur përfaqësuesit e OJF-ve, parlamenti nuk është OJF. Ai ka detyra eksplicite të caktuara, ka kontroll parlamentar mbi ligjet që miraton dhe mbi ekzekutivin që ka zgjedhur. Kështu, neglizhenca në afatet kohore, kur ligji e përcakton 3 muaj dhe kanë kaluar 1 vit e 3 muaj pa dalë aktet nënligjore, nuk do të tolerohet më nga ligjvënësit shqiptarë. Kjo të jetë e prerë!

Është shumë interesante ajo që është diskutuar, teza, që bashkë me projektligjin të vijë edhe projekti i akteve nënligjore, çështje të cilën ne, si parlamentarë, duhet ta gjykojmë dhe ta vlerësojmë së bashku me ekzekutivin.

Lidhur me disa ide që u hodhën këtu, ku i pari që konstatimi i zotit Hazizaj që ligji për gjendjen civile ka mjaft probleme dhe ato duhen bërë një herë e mirë, unë nuk mund të flas se sa probleme ka. Ju mund të keni absolutisht të drejtë, por unë do të thosha se nuk mund të presim një studim tjetër për këtë çështje dhe ta shtyjmë për kalendat greke këtë ndryshim që duhet të bëjmë. Ne do ta bëjmë ndryshimin brenda muajit për ta zgjidhur problemin. Bile, unë

mendoj se koha në të cilën jetojmë, pas vitit 1990, ka nxjerrë probleme të reja për të gjitha çështjet që trajtuat ju, të cilat ligjet tona nuk i kanë.

Unë po shtoj se koha ka nxjerrë probleme të llojit, që në Shqipëri nuk regjistrohesh kur lind.

A e dini se cili është problemi i dytë? Nuk regjistrohesh as kur vdes. Koha ka nxjerrë problemet që në Shqipëri nuk regjistrohesh kur lind dhe, problemi i dytë, kur vdes. Ka neglizhencë në këtë gjë. Në listat e Gjendjes Civile ka qindra për të mos thënë mijëra persona 130 apo 150 vjeç, edhe pse kanë 40 vjet që kanë vdekur, ende të pa çregjistruar.

Këtu është edhe drejtori i Gjendjes Civile, i cili ka propozuar një ndryshim me procedurë të përsheptuar, të cilin do t'ia pasurojmë ne me ndryshimet që do të bëjmë në paketën që propozojmë për të rregulluar regjistrimet, por absolutisht duhet rregulluar çregjistrimi. Të gjitha këto shqetësime duhet të shërbejnë si impute që ju si drejtori e Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme problemet e reja që ka nxjerrë koha në të cilën jetojmë t'i pasqyroni në ndryshimet që do të bëjmë për ta parë ligjin në tërësi. Unë ju përgëzoj për propozimet që keni bërë për dhunën seksuale ndaj fëmijëve, të cilat kanë ardhur në përgjigje të shqetësimeve që u ngritën. Menjëherë ne do t'ia çojmë Ministrisë së Drejtësisë për të dhënë mendimet. Sigurisht, ky është një kod që kërkon shumicë të cilësuar votash.

Nuk është detyra juaj, por kontributi juaj që, në të gjithë punën e lavdërueshme që bëni si shoqata, të punoni qoftë edhe me ne deputetët dhe forcat politike. Ka plotë gjëra që na ndajnë dhe polarizimi i jetës politike mund të bëhet për gjithçka, por jo për çështje që zgjidhin qoftë edhe një problem siç është dhuna seksuale ndaj fëmijëve. Ligji kërkon shumicë të cilësuar votash.

Nga përfaqësuesit të OJF-ve këtu u trajtuan edhe probleme të tjera, për të cilat ju keni mendimet tuaja, të cilat unë i inkurajoj dhe ju kërkoj që të loboni më shumë me deputetë të veçantë dhe me grupe deputetësh të të gjitha forcave politike. Unë e vlerësoj shumë që gjatë sesionit të kaluar pati një përmirësim relativ të iniciativës së deputetëve për projektligje, ashtu sikurse edhe iniciative të qytetarëve për çështje të tjera, prandaj ju inkurajoj që të ecim në këtë në këtë rrugë sëbashku. Nëse do të keni shqetësime të fushave që mbulonin dhe që kërkojnë ndryshime ligjore, duke kooperuar dhe bashkëpunuar me deputetë të veçantë, do të marrim nisma të tjera, siç është kjo, që faktikisht është një nismë e ardhur nga poshtë, për ta zgjidhur problemin. Do t'ju lutesha deputetëve dhe ekzekutivit që për problemin e vendosjes së ADN-së, në pamundësi të përballimit financiar të çështjes nga persona të caktuar, të mund të kishte një përgjigje për nismën e marrë. Nga ajo që më thonë është mbi 400 dollarë.

Kështu që, ju falenderoj të gjithëve dhe mirë u takofshim duke zgjidhur kështu qëllimin për të cilin jemi ngritur!

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**